



Datë: 13.01.2026
Numër Protokolli: 77/2026

A.nr.1889/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtare, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1889/2025, të datës 10.11.2025, të parashtruar nga ankuesi, B.B kundër organit të punësimit: Komuna e Drenasit, në çështjen juridike “*shkelje e të drejtës në pagë*”, duke vepruar sipas nenit 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenit 16, paragrafi 3 dhe nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 13.01.2026, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa A.nr.1889/2025, e datës 10.11.2025, e parashtruar nga ankuesi, B.B.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil B.B, (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 10.11.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me kategorizimin e pozitës së tij të punës nga niveli Profesional 1 në Specialist.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Drenasit, ndërsa, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankuesit është e palejuar, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi është i punësuar në Komunën e Drenasit dhe se i njëjti sipas akt emërimit me numër protokolli 67775, të datës 13.11.2018, ushtron pozitën e punës Zyrtar i Lartë për Gis, në Drejtorinë e Inspektionit.

Ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mbi pretendimin ankimor për kategorizimin e pozitës së tij të punës nga klasa Profesional 1, në kategorinë Specialist. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të obligoj Komunën e Drenasit për avancimin e pozitës së tij në Specialist.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me pranueshmerinë e ankesës iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3 ku përcaktohet se: *3. Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil*, si dhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht neni 124 ku përcaktohet se: *1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim*, dhe si rrjedhojë referuar dispozitave përkatëse ligjore konstatoi se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme të cilat burojnë nga marrëdhënia e punës, mirëpo kur kemi të bëjmë me realizimin e të drejtave sikurse në rrethanat e rastit konkret, nëpunësi civil fillimisht duhet t'i drejtohet organit të punësimit me kërkesë për realizimin e të drejtës se pretenduar dhe vetëm kundër aktit për refuzimin e kërkesës apo heshtjes se organit publikë në raport me kërkesën e parashtruar, mund të parashtroj ankesë sipas afateve të përcaktuara me dispozitat e nenit 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, bazuar në kudrin përkatës ligjor si dhe nga shqyrtimi dhe analizimi i shkresave të lëndës të percjella nga palët në procedurë ka konstatuar se ankuesi lidhur me objektin e ankesës gjegjësisht lidhur me të drejtën e tij nuk i është drejtuar paraprakisht me kërkesë organit të punësimit, gjegjësisht Njesisë për Burime Njerëzore në Komunën e Drenasit, veprim ky i domosdoshëm për iniciimin e procedurës administrative sipas dispozitave të ligjit përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Si rrjedhojë, në mungesë të kërkesës se parashtruar të organi i punësimit për realizimin e të drejtës se pretenduar, nga ankuesi, në rastin konkret nuk kemi objekt trajtimi ngase mungon veprimi apo mosveprim nga organi i punësimit në raport me të drejtën e pretenduar në ankesë, për çka ankuesi mund të kontestonte ligjshmërinë e veprimit të organit të punësimit, apo mosveprimin e tij.

Kështu që, Kolegji konstaton se në rrethanat e rastit konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për pranueshmerinë e ankesës në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe se duke u mbështetur në dispozitat e nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi që të hedhë poshtë ankesën si të palejueshme, ashtu sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1889/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, B.B;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Drenasit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.